



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1101/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Krenare (Latifi) Kqiku kandidate për asamble kuvendit komunale nga rradhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) në Gjilan, paraqitur kundër Qendrës së numrimit të rezultateve, për shkak të manipulimit të votave dhe parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Krenare (Latifi) Kqiku kandidate për kuvendin komunal në Gjilan nga radhët e subjekti politik LVV.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, Krenare (Latifi) Kqiku anëtare e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), konkretisht anëtare për asamble komunale në komunën e Gjilanit, në të cilën thekson se ka pasur abuzim dhe manipulim të votave në vendvotimin me numër 0408/02R në të cilën ajo pretendon se figurojnë 13 (trembëdhjetë) vota, ndërsa në publikimin e rezultateve përfundimtare të KQZ të datës 02.12.2013 figurojnë 12-të (dymbëdhjetë) vota. Sipas FRK-së në vendvotimin 0445D/01D, pretendon se figuron 1 (një) votë, ndërsa në publikimet KQZ-së të datës 02.12.2013, nuk figuron asnjë votë. Parashtruesja e ankesës sipas FRK-së se në vendvotimin 0405D/02D sipas KQZ të datës 02.12.2013 është publikuar 1(një) votë ndërsa sipas FRK-së së ajo thekson se pari figuron numri 2 pastaj numri 1. Edhe në qendrat e votimit me numër 0406D si dhe në të gjitha vendvotimet (0406D/01R, 0406D/02R, 0406D/03R, 0406D/04D) mendon se janë 11 (njëmbëdhjetë) vota, parashtruesja e ankesës dyshon për parregullsi dhe sipas familjarëve të saj janë 22 vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesës Krenare (Latifi) Kqiku nga komuna e Gjilanit. PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse ashtu siç pretendon pala ankuese, andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-it lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1101/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.